



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

Nr. 608/1, Datë 25.1.2023.

**“Mbi korrigjimin e vendimit nr. 608, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Elion Mustafaj”**

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Olsi Komici</b>	<b>Anëtar</b>

Bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Trupi gjykues u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes znj. Firdes Shuli, për korrigjimin e gabimit material në vendimin nr. 608, datë 22.12.2022, të subjektit të rivlerësimit Elion Mustafaj.

Në vendimin nr. 608, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është konstatuar prania e gabimeve materiale si më poshtë:

- Në rreshtin e dytë të paragrafit nr. 30 të vendimit është shkruar togfjalëshi “në kontratën e sipërmarrjes datë 4.6.2007”, ndërkohë duhet të jetë “në kontratën e sipërmarrjes datë 29.09.2005”.
- Në rreshtin e parë të paragrafit nr. 82 të vendimit është shkruar togfjalëshi “seanca dëgjimore e datës 22.12.2022”, ndërkohë duhet të jetë “seanca dëgjimore e datës 21.12.2022” dhe rreshtin e fundit të po këtij paragrafi është shkruar togfjalëshi “në seancën e datës 23.12.2022”, ndërkohë duhet të jetë “në seancën e datës 22.12.2022”.
- Në fund të vendimit është shkruar togfjalëshi “ky vendim u shpall në Tiranë në datën 23.12.2022.”, ndërkohë që duhet të jetë “ky vendim u shpall në Tiranë në datën 22.12.2022”.

Trupi gjykues, pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësitë janë vendosur dukshëm si pasojë e gabimeve materiale,

## **V E N D O S I:**

1. Ndrejten e gabimeve materiale në vendimin nr. 608, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në këtë mënyrë:
  - Togfjalëshi “në kontratën e sipërmarrjes datë 4.6.2007” në rreshtin e dytë të paragrafit nr. 30 të vendimit, bëhet “në kontratën e sipërmarrjes datë 29.09.2005”.
  - Togfjalëshi “seanca dëgjimore e datës 22.12.2022” në rreshtin e parë të paragrafit nr. 82 të vendimit, bëhet “seanca dëgjimore e datës 21.12.2022” dhe togfjalëshi “në seancën e datës 23.12.2022” në rreshtin e fundit të po këtij paragrafi, bëhet “në seancën e datës 22.12.2022”.
  - Togfjalëshi “ky vendim u shpall në Tiranë në datën 23.12.2022.” në fund të vendimit, bëhet “ky vendim u shpall në Tiranë në datën 22.12.2022”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këto korigjime.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

<b>Kryesuese</b>	<b>Relatore</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Firdes Shuli</b>	<b>Olsi Komici</b>